

20130691471

**L I G J**  
**PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL**

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12 dhe 15/13), pas nenit 14 shtohet neni i ri 14-a, si vijon:

"Detyrime për taksë të kullosave dhe kompensim uJOR  
Neni 14-a

Shfrytëzuesit e mjeteve nga neni 14 paragrafi 1 i këtij ligji, duhet t'i kenë përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Kullosa që dalin nga marrëveshjet e lidhura për shfrytëzimin e kullosave shtetërore dhe t'i kenë përmbushur të gjitha detyrimet financiare për kompensim uJOR në bazë të evidencës që mbahet në ndërmarrjet e ekonomisë së ujërave, duke përfshirë edhe evidencën e debitorëve nga regjistri i bashkësive uJore në territorin e ndërmarrjeve të ekonomisë së ujërave, për vitin paraprak lidhur me vitin në të cilin do të mund ta realizojnë të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve."

Neni 2

Të drejtë shfrytëzimi të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2013 mund të kenë edhe shfrytëzuesit të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk i kanë përmbushur detyrimet në pajtim me nenin 14-a të këtij ligji për vitin 2011, e do t'i përmbushin më së voni deri më 30 tetor 2013 dhe do të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve në Agjencinë për Përkrahje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni të drejtë shfrytëzimi të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2013, mund të kenë edhe personat që nuk kanë mundur të lidhin marrëveshje për shfrytëzim të ujit për ujitje për shkak të mospasjes së dokumentacionit përkatës të ndërmarrjeve të ekonomisë së ujërave dhe bashkësive uJore, në bazë të dëshmisë përkatëse për këtë nga këto ndërmarrje të ekonomisë së ujërave dhe bashkësive uJore që kryejnë ujitjen e rajonit që i përfshin sipërfaqet bujqësore të personave që mund t'i shfrytëzojnë mjetet nga neni 14 paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".